


AKT THEMELIMI
Per krijimin e Shoqerise me Pergjegjesi te
Kufizuar " ALBANIA EXPERIENCE " sh.p.k.

Ne Tirane, sot me date 18 tetor 2005 (dymije e pesë) vullnetin e tij te lire dhe te plete harton kete Akt Themeli:
ORTAKU I VETEM : **Gazmend HAXHIA**, i biri Haxhiu, dtl.07.06.1968, lindur dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i pasaportes me numer Z0787828, madhor dhe me zotes, te plete juridike per te vepruar.



N E N I I

Krijohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " ALBANIA EXPERIENCE " sh.p.k., me **Seli ne Tirane, Hotel Rogner Europapark, Blevardi: "Deshmoret e Kombit"**. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje kohe prej 30 vjetesh. Si dite e fillimit do te merret data e rregjistrimit te saj ne Gjykatene e Rrethit Gjyqesor Tirane. Ortaku i Vetem me vullnetin e tij te lire ka te drejte ta zgjase kete asfat.

N E N I II

Shoqeria eshte person juridik dhe zhvillon aktivitetin e saj ne Republiken e Shqiperise. Per arritjen e qellimit te saj mund te hape sektore dhe filiale brenda territorit te Republikes se Shqiperise ne perputhje me ligjin, dispozitat e ketij akti dhe statutit.

N E N I III

Shoqeria gezon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit te saj dhe legjisacionit ne fuqi. Statuti i shoqerise i bashkangjitet kesaj kontrate dhe eshte pjesa perberese e saj.

N E N I IV

Objekti i veprimtarise se Shoqerise " ALBANIA EXPERIENCE " sh.p.k. eshte si vijon:

- Shitje bileta avioni, trageti dhe treni ne te gjitha destinacionet qe menaxhojne shoquerite perkatese.
- Udhetime turistike ne te gjitha destinacionet turistike ne Shqiperi dhe ne bote, sipas kerkeses se klientit.
- Paketa turistike.
- Trekking, peshkim, gjueti, ski, zhytje nen uje, etj..
- Prenotim hoteli.



- Makina me qera.
- Shoqerues/guide sipas kerkeses se klientit.
- Transport me automjete dhe me shofere.
- Asistence profesionale per organizimin dhe zhvillimin e aktiviteve te tjera ne fushen e biznesit, kultures, sportit, artit, etj..
Pagese e sherbimeve : me para ne dore, me xhirim bankar, me karte krediti, etj..
- Reklama, pasuri e paluajtshme, marketing, tregeti mallrash, sherbime konsulence, menaxhim hotelerie, sherbime kembim parash.

N E N I V

Mbas regjistrimit si person juridik, do te kryen formalitetet e nevojshme per regjistrimin ne Regjistrin Tregtar, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

N E N I VI

Shoqeria per gjigjet per aktivitetin e saj ne baze te pasurise se saj. Ajo nuk per gjigjet per detyrimet personale te perfaquesuesit te saj.

N E N I VII

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100.000 leke (njeqindmije)**.

N E N I VIII

Fitimi i realizuar nga shoqeria mbas derdhjes se detyimeve ligjore i kalon ortakut te vetem te shoqerise.

N E N I IX

Drejtimi, organizimi, administrimi dhe probleme te tjera te lidhura me to jane te percaktuara ne Statut.

N E N I X

Shperndarja e shoqerise mund te behet me perfundimin e kohes se parashikuar, kur hapet nje procedure falimentimi si dhe ne te gjitha rastet e parashikuara nga Ligji "Per shoqerite tregtare".

Po keshtu ne perputhje me Ligjin "Per shoqerite tregtare" shoqeria mund te bashkohet me shoqeri te tjera.

Ky akt themelimi u perpilua ne kater kopje, u miratua nga ortaku i vetem i shoqerise dhe u nenshkrua rregullisht perpara noteres.

O R T A K U I V E T E M
Gazmend HAXHIA


Gazmend Haxhia

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
TIRANE
Nr. 6626 Rep.
Nr. 510 Kol.

V E R T E T I M

Sot me date 18 tetor 2005 (dymije e pese), para meje noteres se Zyres se Noterise Tirane **Blerina AVRAZI**, me adresë Rr."Durresit", pall.204, u paraqit personalisht z.**Gazmend HAXHIA**, i biri Haxhiut, dti.07.06.1968, lindur dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i pasaportes me numer Z0787828, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, i cili deklaroi se sa me siper eshte **Akti i Themelimit i Shoqerise " ALBANIA EXPERIENCE " sh.p.k.**, i redaktuar jashtë kesaj zyre dhe shpreh vullnetin e tij te lire dhe te plete, nenshkruehet rregullisht perpara meje noteres dhe une e vertetoj ate sipas ligjes.

N O T E R E
Blerina AVRAZI



ff

S T A T U T I
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ ALBANIA EXPERIENCE ” sh.p.k.

N E N I I



Formohet Shoqeria «ALBANIA EXPERIENCE» sh.p.k., me Orfak te Vetem z.Gazmend HAXHIA, i biri Haxhiut, dtl.07.06.1968, lindur dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i pasaportes me numer Z0787828, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.

Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit dhe do te zhvilloje aktivitetin e saj privat ne baze te legjpcionit shqiptar.

VENDQENDRIMI
N E N I II

Selia e shoqerise do te jetet ne Tirane, Hotel Rogner Europapark, Blvd: “Deshmoret e Kombit” dhe aktiviteti i saj do te zhvillohet per nje kohe 30 vjecare. Shoqeria mund te hape filiale per zhvillimin e aktivitetit te saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise sipas ligjeve ne fuqi.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE
N E N I III

Objekti i veprimtarise se Shoqerise «ALBANIA EXPERIENCE» sh.p.k. eshte si vijon:

- Shitje bileta avioni, trageti dhe treni ne te gjitha destinacionet qe menaxhojne shoqerite perkatese.
- Udhetime turistike ne te gjitha destinacionet turistike ne Shqiperi dhe ne bote, sipas kerkeses se klientit.
- Paketa turistike.
- Trekking, peshkim, gjueti, ski, zhytje nen uje, etj..
- Prenotim hoteli.
- Makina me qera.
- Shoquerues/guide sipas kerkeses se klientit.
- Transport me automjete dhe me shofere.
- Asistence profesionale per organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve te tjera ne fushen e biznesit, kultures, sportit, artit, etj..
- Pagese e sherbimeve : me para ne dore, me xhirim bankar, me karte krediti, etj..
- Reklama, pasuri e paluajtshme, marketing, tregti mallrash, sherbime konsulence, menaxhim hotelerie, sherbime kembim parash.

KAPITALI I SHOQERISE N E N I IV

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke (njeqindmije), i formuar ne mase te plote nga Ortaku i Vetem Gazmend HAXHIA.

N E N I V

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre Ortaku i Vetem i shoqerise.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI N E N I VI

Shoqeria "ALBANIA EXERIENCE" sh.p.k. deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj si person juridik ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe ndersa ushtron aktivitetin e saj tregtar me regjistrimin e saj ne Zyren e Tatimeve.

N E N I VII

Shoqeria vepron ne regimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet. Ajo per gjigjet vete per te drejtat dhe detyrimet e saj kontraktore brenda kapitalit te saj. Ortaku i vetem mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne Shoqeri.

N E N I VIII

Shoqeria eshte themeluar nga Ortaku i Vetem z.Gazmend HAXHIA. Ai i merr vendimet ne zbatim te vendimeve e ligjeve qe jane ne fuqi dhe sipas ketij statuti, te cilat jane te detyrueshme per te gjithe te punesuarit ne kete shoqeri.

N E N I IX

Ortaku i Vetem sipas nevojave te shoqerise emeron administratore si dhe puneson punetore te veprimtarise se vetme ekonomike te permendur ne Nenin 3 te ketij statuti.

N E N I X

Ortaku i Vetem dhe administratori i ngarkuar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite ligjore per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqersise pa asnje lloj kufizimi. Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderojne te nevojshem per arritjen e qellimit te shoqerise. Ata kane te drejte midis te tjerash te lidhen me shoqeri te tjera brenda dhe jashte vendit, te kryejne cdo lloj veprimi pune prane te gjitha zyrave private apo shteterore, qe kane te bejne me garancite, hipotekat, etj.. Te kryejne prane institucioneve bankare dhe financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa e

arketime. Administratori ka per detyre te njoftoje dhe t'i jape llogari Ortakut te Vetem. **Administrator i Shoqerise " ALBANIA EXPERIENCE " sh.p.k. eshte z.Gazmend HAXHIA.**

N E N I XI

Perfaqesimi i shoqerise i perket Ortakut te Vetem dhe Administratorit te ngarkuar prej tij. Ata kane te drejten e perfaqesimit te shoqerise ne organet gjyqesore dhe administrative si dhe te angazhujne avokate per cdo problem apo te autorizojne persona me prokure.

BILANCI DHE TE ARDHURAT N E N I XII

Veprimet ekonomike dhe financiare te shoqerise mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore administratori nxjerr bilancin kontabel te shoqerise ne llogarine Fitim-Humbje, ne perputhje me ligjet dhe rregullat e mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet tregtare, percaktuar nga organet kopetente te sistemit fiskal. Bilanci kontabel miratohet nga Ortaku i Vetem, i cili vendos per krijimin e fondeve ligjore te ndryshme te nevojshme per zhvillimin e veprimitarise ekonomike te shoqerise si dhe fondin e akumulimit dhe fondin rezevre te tij.

N E N I XIII

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve ligjore te permendura me siper dhe shlyerjes se detyrimeve fiskale i mbesin per perdonim ortakut te vetem.

SHPERNDARJA E SHOQERISE N E N I XIV

Shperndarja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe, si humbje e kapitalit, pamundesi veprimitarie, etj.. Ne keto raste Ortaku i Vetem vendos mbi menyren e likujdimit dhe caktimin e nje ose me shume likujdatoreve.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME N E N I XV

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve te bera nga Ortaku i Vetem i shoqerise si dhe ligjeve perkatese shqipetare.